

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Kontabiliteti Financiar

P1

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Shënim: Emrat e individëve, vendeve dhe kompanive, të përdorura në këtë provim janë fiktive. Çdo ngjashmëri është plotësisht e rastësishme

Data 20.01.2024

Problemi 1

Arta BI është biznes që bënë shitje me pakicë në pronësi të Artës. Bilanci vërtetues i biznesit më datë 31 mars 2023 nuk u barazua. Diferenca u transferua në llogarinë pezull dhe u përgatitën draft llogaritë. Sipas draft llogarive, u paraqit fitimi neto prej 1,875,000 eur për vitin që përfundon më 31 mars 2023. Arta BI mban llogari kontrolluese për llogari të arkëtueshme dhe të pagueshme tregtare.

Janë identifikuar gabimet dhe lëshimet e mëposhtme:

- (1) Shpenzimet e energjisë elektrike prej 35,000 eur për muajin mars 2023 janë debituar në llogarinë e shpenzimeve të energjisë elektrike si 53,000 eur. Megjithatë, hyrja në kredi është regjistruar saktë.
- (2) Regjistrimi i dyfishtë lidhur me shpenzimet akruale të qirasë prej 135,000 eur për muajin mars 2023 është regjistruar dy herë në librat kontabël.
- (3) Totali i librit të shitjeve ditore është nënvlerësuar për 180,000 eur.
- (4) Interesi nga overdrafti bankar prej 2,500 eur i ngarkuar nga banka është kredituar në llogarinë e të hyrave nga interesi. Megjithatë, kjo është regjistruar saktë në librin e arkës.
- (5) Blerja e kompjuterit me vlerë 150,000 eur më 1 janar 2023 është debituar në llogarinë e shpenzimeve të riparimit dhe mirëmbajtjes. Megjithatë, kjo është regjistruar saktë në librin e arkës. Kompjuterët janë zhvlerësuar me 20% në vit në koston e tyre sipas metodës drejtvizore.

Kërkohet:

- (a) Përgatitni hyrjet në ditar për të korrigjur gabimet e mësipërme.**
- (b) Llogaritni fitimin neto të korrigjuar për vitin që përfundon më 31 mars 2023.**

[Total: 20 pikë]

Zgjidhja e problemit 1**(a)**

	Përshkrimi		Debi	Kredi
01	Llogaria pezull Shpenzimet e energjisë elektrike (Korigjimi i gabimit të regjistrimit të shpenzimeve të energjisë elektrike prej 35,000 e cila është regjistruar si 53,000)	D K	18,000	18,000
02	Qiraja pagueshme Shpenzimet e qerase (Korigjimi i gabimit të qirasë të regjistruar dy herë 135,000)	D K	135,000	135,000
03	Llogaria kontrolluese e të arkëtueshmeve Te hyrat nga shitja (Korigjimi i gabimit të nënvlerësimit të librit ditor të shitjeve për 180,000)	D K	180,000	180,000
04	Shpenzimet e interesit Te hyrat nga interesi Llogaria pezull (Korigjimi i gabimit të regjistrimit të interesit të overdraftit bankar prej 2500 eur si interes në llogarinë e të hyrave të interesit)	D D K	2,500 2,500	5,000
05	Kompjuteret Shpenzimet e riparimit dhe mirëmbajtjes (Korigjimi i blerjes së kompjuterit i cili është regjistruar në llogarinë e shpenzimeve të riparimit dhe mirëmbajtjes)	D K	150,000	150,000
06	Shpenzimet e zhvlerësimit Llogaria e zhvlerësimit të akumuluar (Regjistrimi i zhvlerësimit për periudhën 3 mujore)	D K	7,500	7,500

(06 pikë)

(b)

Arta BI

Llogaritja e fitimit të korrigjuar për vitin e përfunduar më 31 mars 2023

Fitimi neto sipas draft llogarive		1,875,000
Plus: Energjia elektrike	18,000	
Qiraja	135,000	
Shitjet	180,000	
Riparimi dhe mirëmbajtja	150,000	483,000
		2,358,000
Minus: Interesi i overdraftit bankar	2,500	
Të hyrat nga interesi	2,500	
Zhvlerësimi i kompjuterit	7,500	(12,500)
Fitimi neto i korrigjuar		2,345,500

Problemi 2

Ekstrakti bankar i Mia SH.P.K tregon saldo kreditore prej 427,400 eur më 31 mars 2023, përderisa llogaria e parave të gatshme tregon një saldo debitore prej 336,000 eur.

Asistenti i kontabilitetit ka identifikuar arsyet e mëposhtme për diferencën në mes ekstraktit bankar dhe saldos së librit të arkës:

- (1) Banka ka zbritur këstin e kredisë prej 25,000 eur në lidhje me kredinë e marr nga banka dhe kjo nuk është regjistruar në librin e arkës.
- (2) Shpenzimet bankare prej 1,500 eur, të ndala për konfirmim bankar nuk ishin regjistruar në librin e arkës.
- (3) Interesi i overdraftit prej 12,100 eur për muajin shkurt është ngarkuar nga banka gjatë muajit mars 2023 dhe nuk është regjistruar në librin e arkës.
- (4) Interesi i depozitës fikse të marrë prej 25,000 eur u kreditua në ekstraktin bankar, por nuk është regjistruar në librin e arkës.
- (5) Një çek prej 120,000 eur është depozituar në bankë por nuk është realizuar në datën 31 mars 2023.
- (6) Një çek prej 225,000 eur u lëshua më 30 mars 2023, por ai nuk u paraqit për pagesë në bankë më 31 mars 2023.

Kërkohet:

Të përgatitni:

- (a) Korigjimin e librit të arkës (Libri i parave të gatshme).
 - (b) Pasqyrën e harmonizuar të bankës më 31 mars 2023. [Total: 20 pikë]
-

Zgjidhja e problemit 2

(a)

Llogaria e kontrollit të parave të gatshme (Libri i arkës)			
Saldo e pakorrigjuar	336,000	Këstet e kredisë	25,000
		Tarifat bankare	1,500
		Interesi i overdraftit bankar	12,100
Interesi i depozitës fikse	25,000	Saldo në fund e korrigjuar	322,400
	361,000		361,000
Saldo në fund e korrigjuar	322,400		

s(b)

Ekstrakti i harmonizimit bankar më 31 Mars 2023	
Saldo e pakorrigjuar	427,400
Plus:	
Depozitat ne tranzit	120,000
Minus:	
Çeqet e paparaqitura	(225,000)
Saldo korrigjuar për ekstraktin bankar	322,400

Problemi 3

Qendra e bukurisë Suzana është ndërmarrje individuale me pronare Suzanën. Bilanci vërtetues më 31 mars 2023 është si më poshtë:

Qendra e bukurisë Suzana
Bilanci vërtetues më 31 mars 2023 (eur '000)

Përshkrimi	D	K
Impiantet dhe pajisjet - kosto:		
Pajisjet e bukurisë	3,500	
Mobiliet dhe pajisjet	5,200	
Zhvlerësimi i akumuluar më 1 prill 2022:		
Pajisjet e bukurisë		625
Mobiliet dhe pajisjet		400
Shitjet		74,100
Blerjet	52,000	
Stoqet më 1 prill 2022	1,750	
Të arkëtueshme tregtare	3,500	
Të pagueshme tregtare		1,050
Para të gatshme	75	
Kredi bankare		560
Shpenzimet e sigurimit	350	
Shpenzimet e energjisë elektrike	1,650	
Shpenzimet e pagave	7,000	
Interesi i kredisë bankare	200	
Qiraja e paguar e zyrës	2,600	
Shpenzimet e transportit	300	
Shpenzimet e ujit	150	
Kapitali më 1 Prill 2022		1,540
Totali	78,275	78,275

Informatat shitesë:

- (1) Stoqet më 31 mars 2023 u vlerësuan me kosto prej 6,750,000 eur.
- (2) Më 31 mars 2023, një nga shokët e Suzanës, furnizoi Suzanën me mobilie në vlerë prej 500,000 eur dhe ajo u pajtua që shumën ta shlyejë në prill 2023. Transaksioni nuk u regjistrua në librat kontabël.
- (3) Politikë e biznesit është që të aplikojë zhvlerësim me metodën drejtvizore si më poshtë:
Pajisjet e bukurisë: 25% për vit

Mobiliet dhe pajisjet: 20% për vit
- (4) Më 1 prill 2022, Suzana ka bërë një marrëveshje të re të qirasë. Bazuar në marrëveshje, qiraja mujore është 200,000 eur. Qiraja për muajin prill 2023 është paguar në mars.
- (5) Për shkak të mungesës të produkteve kozmetike në tregun e hapur, Suzana ka blerë disa produkte nga Turqia gjatë udhëtimit të saj personal dhe ka përdorur kredit kartën personale më 20 mars 2023. Kostoja e produkteve të blera nga Turqia ishte 900,000 eur dhe ajo u pajtua që këtë vlerë ta shtojë në kapitalin e biznesit. Megjithatë, i gjithë ky transaksion nuk ishte regjistruar në librat kontabël të biznesit të Suzanës. Në vazhdim, ky stok është shitur gjatë muajit mars 2023 dhe transaksionet e shitjeve janë regjistruar saktë në librat kontabël të biznesit.
- (6) Suzana ka vendosur të shlyejë saldon e llogarive të arkëtueshme prej 155,000 eur prej ABC SH.P.K si borxh i keq.
- (7) Fatura e energjisë elektrike prej 78,000 eur për muajin mars 2023 nuk është paguar më 31 mars 2023.

Kërkohet të përgatitni:

- (a) Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin që përfundon më 31 mars 2023.
- (b) Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 mars 2023.

[Total: 20 pikë]

Zgjidhja e problemit 3

a)

Qendra e bukurisë Suzana
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin që përfundon më 31
mars 2023

		EUR'000
Shitjet		74,100
Kosto e shitjeve:		
Stoku fillestar	1,750	
Blerjet (52,000 + 900)	52,900	
	54,650	
Stoqet përfundimtare:	(6,750)	(47,900)
Fitmi bruto		26,200
Shpenzimet :		
Borxhet e këqija	155	
Shpenzimet e transportit	300	
Zhvlerësimi:		
- pasisjeve të bukurisë	875	
- mobilieve dhe pajisjeve	1,040	
Shpenzimet e qerase	2,400 (2,600-200*)	
Shpenzimet e ujit	150	
Shpenzimet e energjise elektrike (1,650+78)	1,728	
Shpenzimet e pagave	7,000	
Shpenzimet e sigurimit	350	
Interesi i kredise bankare	200	
Fitimi neto për vitin		12,002
*Qeraja e prillit 2023 duhet te hiqet sepse eshte parapagim		

(10 pikë)

(b)

Pasqyra e pozicionit financiar të biznesit të Qendres së bukurisë Suzana

	Më 31 mars 2023		(eur'000)
	Kosto	Zhvlerësimi i akumuluar	Vlera e mbetur
Pasuritë jo - qarkulluese			
Pajisjet e bukurisë (LL1)	3,500	1,500	2,000
Mobilitet dhe pajisjet (LL1)	5,700 (5,200+500)	1,440	4,260
	9,200	2,940	6,260
Pasuritë qarkulluese			
Stoqet		6,750	
Të arkëtueshme tregtare (3,500 - 155)		3,345	
Parapagimet e qerase		200	
Para të gatshme		75	10,370
Total pasuritë			16,630
Ekuiteti dhe detyrimet			
Ekuiteti			
Kapitali aksionar më 1 prill 2022		1,540	
Kapitali shtesë		900	
Fitimi për vitin		12,002	14,442
Detyrimet afatgjata			
Kredia bankare			560
Detyrimet afatshkurta			
Të pagueshme tregtare		1,050	
Të pagueshme tjera		500	
Akrualet		78	
Totali i ekuitetit dhe detyrimeve			16,630

LL1 – Zhvlerësimi

	Zhvlerësimi i akumuluar	Zhvlerësimi i vitit	Zhvlerësimi i akumuluar
	1.4.2022		31.03.2023
Pajisjet e bukurisë	625	875	1,500
Mobilitet dhe pajisjet	400	1,040	1,440
	1,025	1,915	2,940

Zhvlerësimi i vitit

Pajisjet e bukurisë	$3,500 \times 25\%$	= 875
Mobilie dhe pajisje	$5,200^{**} \times 20\%$	= 1040

***Nuk zhvlerësohet kete vit pasuria e blere me 31 mars 2023*

Problemi 4

Suzana ka blerë 80% të ekuitetit të Kiaraes më 1 janar 2023 për 120,000€ kur fitimet e mbajtura të Kiaraes ishin 50,000€. Vlera e drejtë e interesit jo-kontrollues në atë datë ishte 40,000€. Gjatë vitit Suzana i shiti Kiaraes mallra që kushtonin 80,000€, me një kosto të faturuar prej 100,000€. Kiara kishte 50% të mallrave ende në stoqe në fund të vitit. Draft pasqyrat financiare të dy kompanive më 31 dhjetor 2023 janë si vijon:

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31 DHJETOR 2023

	<i>Suzana</i> €000	<i>Kiara</i> €000
Të hyrat	5,000	1,000
Kosto e shitjeve	<u>2,900</u>	<u>600</u>
Fitimi bruto	2,100	400
Shpenzimet e tjera	<u>1,700</u>	<u>320</u>
Fitimi para tatimit	400	80
Tatimi	<u>130</u>	<u>25</u>
Fitimi neto i vitit	<u><u>270</u></u>	<u><u>55</u></u>

PASQYRA E POZITËS FINANCIARE MË 31 DHJETOR 2023

	<i>Suzana</i> €'000	<i>Kiara</i> € '000
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Investimet në Kiara	120	–
Pasuritë jo-qarkulluese të prekshme	<u>1,880</u>	<u>200</u>
	<u>2,000</u>	<u>200</u>
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Stoqet	500	120
Llogaritë e arkëtueshme	650	40
Paraja në bankë	<u>390</u>	<u>35</u>
	<u>1,540</u>	<u>195</u>
	<u><u>3,540</u></u>	<u><u>395</u></u>
<i>Ekuiteti dhe Detyrimet</i>		
<i>Ekuiteti</i>		
Kapitali aksionar	2,000	100
Fitimi i mbajtur	<u>400</u>	<u>200</u>
	<u>2,400</u>	<u>300</u>
<i>Detyrimet afatshkurta</i>		
Llogaritë e pagueshme	910	30
Tatimi	<u>230</u>	<u>65</u>
	<u>1,140</u>	<u>95</u>
	<u><u>3,540</u></u>	<u><u>395</u></u>

Kërkohet

Përgatitni pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe pasqyrën e konsoliduar të pozitës financiare të Grupit Suzana më 31 dhjetor 2023. (**Totali 20 pikë**)

Zgjidhja e problemit 4

GRUPI SUZANA

PASQYRA E KONSOLIDUAR E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE PËR FITIN QË MBARON MË 31 DHJETOR 2023

€'000

Të hyrat (5,000 + 1,000 – 100*)

5,900

Kosto e shitjeve(2,900 + 600 - 100* + 10(LL2))	3,410
Fitimi bruto	2,490
Shpenzimet e tjera (1,700 + 320)	2,020
Fitimi para tatimit	470
Tatimi (130 + 25)	155
Fitimi i vitit	315
<i>Fitimi i atribuohet:</i>	
Mbajtësve të ekuitetit të kompanisë mëmë (sh.bal.)	304
Interesi jo-kontrollues (20% × €55,000)	11
	315

* Largo tregtinë brenda grupit

PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZITËS FINANCIARE MË 31 DHJETOR 2023

	€'000	€'000
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Zëri i mirë (LL1)	10	
Pasuritë jo-qarkulluese të prekshme (1,880 + 200)	2,080	
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Stoqet (500 + 120 - 10(LL2))	610	
Llogaritë e arkëtueshme (650 + 40)	690	
Paraja në bankë (390 + 35)	425	
		1,725
		3,815
<i>Ekuiteti dhe detyrimet</i>		
<i>Ekuiteti që i takon mbajtësve të kompanisë mëmë</i>		
Kapitali aksionar (vetëm Suzana)		2,000
Fitimi i mbajtur (LL3)		512
		2,512
Interesi jo-kontrollues (LL4)		68
Total ekuiteti		2,580
<i>Detyrimet afatshkurtra</i>		
Llogaritë e pagueshme (910 + 30)	940	
Tatimi (230 + 65)	295	
		1,235
<i>Total ekuiteti dhe detyrimet</i>		3,815

Llogaritjet

1	Zëri i mirë	€'000	€'000
	Vlera e drejtë e konsideratës së transferuar		120
	Plus vlera e drejtë e IJK-së në blerje		40
	Minus vlera e drejtë neto e pasurive të identifikueshme të blera të përfaqësuara nga:		
	Kapitali aksionar	100	
	Fitimet e mbajtura	<u>50</u>	
			<u>(150)</u>
	Zëri i mirë		<u>10</u>
2	Kalkulimi për fitimin e parealizuar		€
	Fitimi nga tregtia brenda grupit (100,000 – 80,000)		20,000
	Fitimi i pa-realizuar (50% × 20,000)		10,000
3	Fitimet e mbajtura	Suzana €'000	Kiara €'000
	Sipas pyetjes	400	200
	Fitimi i pa-realizuar (LL2)		(10)
	Fitimet e mbajtura para blerjes		<u>(50)</u>
			<u>140</u>
	Pjesa e grupit e fitimeve të mbajtura pas blerjes:		
	Kiara (80% × 140)	<u>112</u>	
	Fitimet e mbajtura të grupit	<u>512</u>	
4	Interesi jo-kontrollues në datën e raportimit		€'000
	Vlera e drejtë e IJK-së në datën e blerjes		40
	Plus pjesa e IJK-së e fitimeve të mbajtura pas blerjes (20% × 140)		<u>28</u>
	IJK në datën e raportimit		<u>68</u>

Problemi 5

Glam Sh.p.k është e përfshirë në prodhimin e produkteve ndërtimore dhe pasqyrat e saj financiare janë si vijon :

“Glam Sh.p.k” Pasqyra e Pozitës Financiare për vitin që përfundon më 31.12.2023

	2023	2022
	€'000	€'000
Pasuritë jo-qarkulluese		
Prona, Impiante Pajisje	7,680	5,910
Total Pasuritë jo-qarkulluese	7,680	5,910
Pasuritë qarkulluese		
Stoqet	2,070	1,830
Llogaritë e arkëtueshme	1,170	1,020
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët	75	168
Total pasuritë qarkulluese	3,315	3,018
Total Pasuritë	10,995	8,928
Ekuiteti & Detyrimet		
Ekuiteti		
Kapitali aksionar	360	300
Premia në aksione	90	75
Fitimet e mbajtura	5,697	3,603
Rezerva e rivlerësimit	180	120
Total Ekuiteti	6,327	4,098
Detyrimet afatgjata		
Huaja afatgjatë	2,250	2,400
Total Detyrimet afatgjata	2,250	2,400

Detyrimet afatshkurtëra

Llogaritë e pagueshme	2,208	2,250
Mbitërheqja bankare	60	90
Detyrimi për tatimin e pagueshëm	150	90
Total Detyrimet afatshkurtëra	2,418	2,430
Total Ekuiteti & Detyrimet	10,995	8,928

Shënime:

- (i) Fitimi para tatimit për vitin i “Glam Sh.p.k” është 2,243,000 €.
- (ii) Shpenzimet e tatimit në fitim për vitin 2023 ishin 63,000 €.
- (iii) Kosto e Pronës, Impianteve dhe Pajisjeve (PIP) më 1 Janar 2023 ishte 7,290,000 €. Politika e zhvlerësimit të kompanisë është të zhvlerësojë të gjitha pasuritë me 10% metoda drejtëvizore, në kosto, nga data e blerjes deri në datën e shitjes. Më 1 Tetor 2023, “Glam Sh.p.k” ka shitur PIP të cilat kishin vlerë neto në libra 520,000 €. Këto PIP kishin kosto historike 800,000 € dhe kompania krijoi një humbje nga shitja prej 20,000 €. Blerjet shtesë të PIP kanë ndodhur më 31 Dhjetor 2023.
- (iv) Kostot e financimit të “Glam Sh.p.k” kapin shumën prej 48,000 €. Ato u paguan plotësisht.
- (v) “Glam Sh.p.k” pagoi 86,000 € dividendë në vitin 2023.

Kërkohet :

Përgatisni Pasqyrën e rrjedhave të arkës për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2023 për “Glam Sh.p.k” sipas SNK 7 – *Pasqyra e rrjedhave të arkës*.

[Total: 20 pikë]

Zgjidhja e problemit 5

Glam Sh.p.k" Pasqyra e rrjedhave të arkës për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2023

Rrjedha e P.G nga aktivitetet operative	€'000	€'000
Fitimi para Tatimit	2,243	
Shpenzimet e zhvlerësimit	709	
Humbja nga shitja e PIP	20	
Shpenzimet e interesit	48	
	3,020	
Rritja në stoqe	- 240	
Rritja në LI/ A	- 150	
Zvogëlimi në LI/P	- 42	
	2,588	
Paraja e gatshme e gjeneruar nga operacionet	- 48	
Interesi i paguar	- 3	
	2,537	
Rrjedha neto e P.G nga aktivitetet operative		2,537
Rrjedha e P.G nga aktivitetet investuese		
Pagesa për blerjen e PIP	- 2,939	
Arkëtime nga shitja e PIP	500	
Rrjedha neto e P.G nga aktivitetet investuese	-	2,439
Rrjedha e P.G nga aktivitetet financuese		
Emetimi i aksioneve	75	
Pagesa e dividendës	- 86	
Pagesa për zvogëlimin e detyrimeve afatgjata	- 150	
	-	161
Rrjedha neto e P.G dhe ekuivalentëve	-	63
P.G dhe ekuivalentët në fillim të vitit	Shënim 1	78
P.G dhe ekuivalentët në fund të vitit	Shënim 1	15

Shënim 1	2023	2022
	€'000	€'000
Paraja e gatshme në dorë dhe në bankë	75	168
Mbitërheqja bankare	- 60	-90
P.G dhe ekuivalentët	15	78
	TOTAL PIKË 20	

Humbja nga shitja e PIP	€'000
Vlera neto në datën e shitjes	520
Çmimi i shitjes	500
Humbja nga shitja e PIP	20

Llogaria e Interesit te pagueshem

Saldo në fillim	-	Shpenzimet e interesit - p/a	48
Interesi i paguar	48	Saldo në fund	-
	48		48

Llogaria e tatimit te pagueshem

Tatimi i paguar	3	Saldo në fillim	90
Saldo në fund	150	Shpenzimet e tatimit-p/a	63
	153		153

Llogaria për Prona, Impiante & Pajisje (PIP)

Saldo në fillim	5,910	Zhvlerësimi	709*
Rezerva e rivlerësimit	60	Pasuria e shitur (VNL)	520
Blerja e PIP (sh.bal)	2,939	Saldo në fund	7,680
	8,909		8,909

*Shpenzimet e zhvlerësimit=(7,290-800)*10%=649

Shpenzimet e zhvlerësimit (Pasuria e shitur)=800*10%*9/12=60

Total shpenzimet e zhvlerësimit=649+60=709